



EITI Shqipëri
Plani i Punës 2021-2022
Shkurt 12 2021

Shënim

Ky dokument paraqet Planin e Punës të EITI-it Shqiptar për vitin 2021- 2022 .

Në këtë dokument EITI Shqipëri dhe MSG kanë përcaktuar objektivat dhe detyrat për tu përmbushur gjatë viteve 2021- 2022.

Rrjedha e natyrshme e procesit EITI na kërkon që të çojmë përpara fazën “E Avacuar- të Performimit” EITI-t. Prandaj ne do të fokusohemi dhe do të investojmë në ato aktivitete të cilat do ti mundësojnë proceseve EITI të jenë ritmike dhe të qëndrueshme.

Për referencë lexuesit:

Standarti EITI: <https://eiti.org/document/eiti-standard-2019>

Kërkesa 1.5 Plani i Punës: <https://eiti.org/document/standard#r1-5>

Programi kombëtar dhe prioritetet qeverisëse janë të listuara: <https://kryeministria.al/wp-content/uploads/2017/11/PROGRAMI.pdf>

Në vijim, janë ato prioritetet kombëtare që do të jenë në formë objektivash në Planin tonë të Punës, në përpjekje për të maksimizuar procesin EITI në vend, dhe ndikojnë në rrugëtimin shqiptar drejt "Rritjes së qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse", i cili është objektivi kryesor i Qeverisë shqiptare!¹

¹<https://kryeministria.al/files/PROGRAMI.pdf>

EITI Shqiptar Plani i Punes 2021- 2022 (ver. 1.1)

1. Lufta kundër Korrupsionit.
2. Mirëqeverisja e Burimeve Natyrore.
3. Përgatitja e një pakete ligjore për Transparencën në Industrinë Nxjerrëse.
4. Adresimi dhe puna për kryerjen brënda afateve të Veprimeve Korigjuese të dala nga procesi i II i Validimit dhe Vendimi i Bordit EITI për Shqipërinë.²
5. EITI Transparency Week, Vlerësimi i impaktit EITI për 10 vjetorin (10 Years of Transparency);
6. Studim për rishikimin ligjor për raportimin në bazë projekti;
7. Vlerësim për impaktin e Ligjit për BO;
8. Scoping Study për Energy Transition në sektorin e Energjive te Rinovueshme : gazit/erës/diellit;
9. Siguria në punë në Sektorin e industrive nxjerrëse;
10. Bashkëpunimi me universitetet dhe botën Akademike për përfshirjen në procesin EITI;
11. Gratë dhe industria nxjerrëse;
12. Mbështetje për Shoqërinë Civile.
13. Për zhvillimin e një standarti për Raportimin Lokal
14. Etj.

Më poshtë, ju do të gjeni një arsyetim të shkurtër në lidhje me objektivat në axhendën EITI dhe prioritetet kombëtare.

1. Lufta kundër Korrupsionit

Qasja e qeverisë shqiptare në luftën kundër korrupsionit përqendrohet në tre drejtime: parandalim, ndërgjegjësim dhe ndëshkim.

Si do të ndikojnë aktivitetet tona EITI në këtë axhendë kombëtare?

Ne planifikojmë ta bëjmë atë nëpërmjet "Reformimit të kornizës ligjore kombëtare për menaxhim më të mirë të burimeve natyrore". Bazuar në gjetjet dhe pikat nevralgjike që i kemi identifikuar gjatë përgatitjes së raporteve tona EITI ne kemi nevojë për të punuar me kornizën tonë ligjore për të mundësuar një rrjedhë normale të procesit të raportimit. Gjatë vitit 2021 EITI Shqipëri do të punojë për miratimin dhe zbatimin e

²https://eiti.org/sites/default/files/documents/2018-11_validation_of_albania.pdf

EITI Shqiptar Plani i Punes 2021- 2022 (ver. 1.1)

ndryshimeve ligjore dhe rregullative të sugjeruara nga "rishikimi ligjor" dhe të rëna dakord me palët e interesit. Zbatimi i ndryshimeve ligjore që do të mundësojnë dhe rregullojnë lirim, botimin dhe të dhënat e hapura për çdo agjenci qeveritare që merret me qeverisjen e burimeve natyrore.

Cili është objektivi ynë EITI në lidhje me pjesën e ndërgjegjësimit në axhendën Antikorrupsion?

1.2 Fuqizimin e MSG përmes pjesëmarrjes më të gjerë të grupeve të interesit dhe ndërtimit të kapaciteteve;

1.3 **Rritja e pjesëmarrjes së publikut dhe angazhimin e palëve të interesit në menaxhimin e burimeve natyrore.** Aktivitete për Rritjen e Ndërgjegjësimit dhe Komunikimi me një fokus të veçantë në komunikim të përshtatur për aktorët tanë që do të synojnë të krijojnë një platformë për debat profesional; ne kemi identifikuar disa partnerë në proceset tona EITI tilla si studentë, akademikë, ligjvënës, analistë, deputetë, etj. Ata duhet të jenë pjesë e proceseve EITI dhe çdo komunikim duhet të përshtatet sipas specifikave të tyre.

2. Mirëqeverisja e Burimeve Natyrore

2.1 Hidrokarburet- Në këtë sektordo të synohet gjithëpërfshirja dhe raportimi EITI në kohë dhe me cilësi, si dhe reflektimi i azhurnuar i te dhenave sektoriale ne Portalin aktiv Open Data

2.2. Industria Minerare- Në këtë sektor do të synohet gjithëpërfshirja dhe raportimi EITI në kohë dhe me cilësi si dhe reflektimi i azhurnuar i te dhenave sektoriale ne Poratlin aktiv te Kadastres Minerare dhe Portalin Open Data

2.3. Në sektorin elektroenergjetik – Do të synohet gjithëpërfshirja e këtij sektori në raportimet EITI dhe rregullimin ligjor të procesit të raportimit në këtë sektor.

Qeveria Shqiptare po synon zhvillimin e mëtejshëm të sektorit Elektroenergjetik dhe të Industrive nxjerrëse, duke e shndërruar atë në një sektor të qëndrueshëm financiarisht, operacionalisht dhe teknikisht. Ajo ka renditur mirëqeverisjen e burimeve natyrore, si pjesë e prioritetëve të saj strategjike në kapitullin Rritje e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse³.

³<https://kryeministria.al/files/PROGRAMI.pdf>

EITI Shqiptar Plani i Punes 2021- 2022 (ver. 1.1)

Në kuadër të Programit të Qeverisë por edhe të prioriteteve tona në vitin 2021-22, përveç fokusit në sektorët e Naftës e të Minierave e cila është duke u mbuluar tërësisht me anë të iniciativës EITI dhe raporteve EITI, ka fokus të veçantë prodhimi i Elektroenergjisë që është futur si risi për herë të parë nga Shqipëria në raportimin EITI.

Cili është Objektiv i EITI në lidhje me Axhendën Kombëtare për Mirëqeverisjen Burimeve Natyrore?

Qendra e aktiviteteve EITI në përputhje dhe me standardet EITI do të jetë Prodhimi dhe publikimi i raporteve EITI në formatin vit + 1. Përmirësimi i çdo Raporti konsektiv EITI do të jetë objektiv kryesor.

Me përfshirjen e suksesshme në raportet EITI 2013 + 2014 të sektorit të Hidroenergjisë, Raportet EITI në vitet e ardhshme do të vazhdojnë të përmbajnë një raportim të plotë për përdorimin e burimeve ujore, me synimin e inkludimit të të dhënave nga Sektorët e Energjisë së Burimeve të Rinovueshme.

Aspekte të rëndësishme që plotësojnë qeverisjen e burimeve natyrore do të jenë në axhendën tonë, të tilla si çështjet Lokale dhe Mjedisi.

3. Të Dhëna të Hapura

Kryeministri Rama ka vënë theksin në një qeverisje të hapur dhe transparente, si një nga prioritetet kryesore të axhendës kombëtare për "krijimin e një shoqërie të drejtë".

Më 18.2.2015, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 147: "Për miratimin e dokumentit të politikave për implementimin e të dhënave të hapura publike dhe krijimin e portalit të të dhënave të hapura"⁴.

Bazuar në këto prioritete dhe me rritjen e kërkesave nga publiku për një qeverisje transparente dhe të përgjegjshme, Shqipëria po kalon transformime shumë të rëndësishme dhe masive në lidhje me axhendën e saj digjitale në E-qeverisje dhe Strategjinë e Shoqërisë së Informacionit si pjesë e angazhimeve OGP të saj në "Të Dhënat e Hapura"⁵.

⁴http://mobile.ikub.al/LIGJE_CATEGORY/PeR-MIRATIMIN-E-DOKUMENTIT-TePOLITIKAVE-PeR-IMPLEMENTIMIN-E-Te-DHENE-Te-HAPURA-PUBLIKE-DHE-KRIJIMIN-E-PORTALIT-Te-Te-DHENE-Te-HAPURA--1508030128.aspx

⁵http://www.inovacioni.gov.al/files/pages_files/Digital_Agenda_Strategy_2015_-_2020.pdf.

EITI Shqiptar Plani i Punes 2021- 2022 (ver. 1.1)

Cili është Objektiv i ynë EITI përsa i përket të Dhënave të Hapura në prioritetet e axhendës kombëtare?

3.1 Në kuadër edhe të prioritetëve të Qeverisë Shqiptare, përfshirja e të Dhënave të hapura për EITI-n dhe qeverisjene Burimeve Natyrore, në prioritetet kombëtare për sistemet e hapuratë të dhënave të qeverisë dhe të punuarit drejt integritit, reflektimin e të dhënave të azhuruara të të dhënave nga Sektorët e Industrisë Nxjerrëse në Portalët e krijuara të Kadastres Minerare dhe Portalin e Open Datat për të siguruar afate kohore, cilësitë të dhënave, ripërdorim dhe efektivitet në kosto.

4. Adresimi dhe puna për kryerjen brenda afateve të Veprimeve Korrigjuese, të dala nga procesi i Validimit dhe Vendimi i Bordit EITI për Shqipërinë

Mbas procesit të Validimit të dytë që u krye në mars 2019, Bordi EITI vendosi më 17 Qershor 2019 që Shqipëria ka bërë **Progres Domethënës** në përgjithësi në zbatimin e Standardit EITI 2016, me përmirësime të konsiderueshme në disa kërkesa individuale.

Bordi njohu përpjekjet e Shqipërisë për të përdorur EITI si një mjet diagnostik të administrimit të qeverisë së financave publike të të ardhurave nxjerrëse. Raportimi publik i transferimeve lidhur me rentën minerare ka krijuar një interes të konsiderueshëm publik. Bordi inkurajon Shqipërinë të forcojë më tej zbulimet publike, veçanërisht të lidhura me shpërndarjen e licencave dhe pjesëmarrjen e shtetit në naftë dhe gaz. Gjithashtu inkurajon gjithëpërfshirjen dhe besueshmërinë e këtyre informacioneve shpjeguese, duke përfshirë nivelin vendor. Bordi mirëpret shqyrtimin e mundësive të Shqipërisë për të shpalosur në mënyrë sistematike të dhënat e kërkuara në Standardin EITI.

Cili është Objektiv i ynë EITI përsa i përket Adresimit dhe punës për kryerjen brenda afateve të Veprimeve Korrigjuese të dala nga procesi i Validimit dhe Vendimi i Bordit EITI për Shqipërinë në prioritetet e axhendës kombëtare?

8.1 Adresimi i menjëhershëm, shpërndarja dhe ndjekja sipas subjektit përkatës të veprimeve korrigjuese dhe përmbushja e tyre brenda afatit të përcaktuar në mënyrë që në validimin e tretë që do të kryhet në vitin 2021 të kemi arritur përmirësimin e gjithë komponentëve që shërbjnë si subjekt vlerësimi në proces.

EITI Shqiptar Plani i Punes 2021- 2022 (ver. 1.1)

5. Mbështetje për Shoqërinë Civile

Në kapitullin Programor për Shtetin e së Drejtës dhe Demokratizimin e Shoqërisë, Qeveria shqiptare e konsideron prioritetet të saj mbështetjen e Shoqërisë Civile. Qeveria Shqiptare është e bindur se me fuqizimin e shoqërisë civile do të kemi një mjet të rëndësishëm që do të plotësojë hendekun midis qytetarëve dhe institucioneve. Objektivi i saj është të promovojë krijimin e një mjedisi të shëndetshëm që inkurajon shoqërinë civile pavarësinë, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë.

Cili është objektivi ynë EITI në lidhje me Axhendën e Shoqërisë Civile?

Nxitja e krijimit të një mjedisi të shëndetshëm që inkurajon pavarësinë e shoqërisë civile, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë në procesin shqiptar EITI.

Më poshtë do të gjeni Tabelën detajuar dhe me kostot përkatëse të aktiviteteve të parashikuara për vitet 2021- 2022.

	Tema	Objektivi	Aktivitet	Personat/Instituci oni Përgjegjës	Afatet Kohore	Kosto	Fonde ne Dispozicion		Status
							Banka Boterore/Donatorë të tjerë	Buxheti Shtetit	
1	Plani i punës 2021	Perpilimi i Planit te punes ne perputhje me Standartin EITI	Planifikimi i aktiviteteve Riorganizimi i aktiviteteve duke perfshire dhe aktivitetet e parealizuara te planit te punes gjate vitit 2020, Miratimi nga MSG	EITI Shqiptar MSG	Janar- Shkurt 2021	Nuk ka			Në vazhdim

EITI Shqiptar Plani i Punes 2021- 2022 (ver. 1.1)

			<p>Prezantimi tek Grupet e Interesit</p> <p>Publikimi online ne faqen zyrtare EITI Shqiptar</p>						
2	Raportimi i aktiviteve vjetore 2020	Përgatitja e Raportit të progresit të ecurisë së punës gjatë vitit 2020 për EITI Shqiptar	<p>Renditja e aktiviteve te kryera nga Sekretariati Shqiptar EITI gjate vitit 2020</p> <p>Analizimi dhe evidentimi i aktiviteve te parealizuara, shkaqet e mosrealizimit.</p>	<p>EITI Shqiptar</p> <p>MSG</p>	Janar – Qershor 2021	Nuk ka			Në proces
3	Shqyrtimi Ligjor dhe Rregullator	Sigurimi i një legjislacioni të qëndrueshëm për zbatimin EITI në Shqipëri	Miratimi i ligjit të ri për Transparencë + komplementar me ligjet dhe udhëzimet e propozuar në fund të procesit të konsultimit	MIE/ MSG EITI Shqiptar/ Qeveria	Gjatë 2021	Nuk ka			Ka filluar procesi i aprovimit me MIE
4	Aktivite Komunikimi	Aktivitetet e Komunikimit për 2021-22	Komunikimi dhe informimi për 2021 (fushata ne media, internet dhe aktivitetet ne median sociale, evente sensibilizuese)	EITI Shqiptar / MSG/ Konsulenti	2021-2022	120000 \$	Banka Botërore/Donatorë të tjerë		Nuk ka filluar
5	Raporti EITI 2019- 2020	Pergatitja e TOR's	<p>Diskutimi dhe miratimi i termave te references nga MSG referuar standarteve EITI</p> <p>Pranimi i termave te references nga Banka Boterore</p> <p>Perzgjedhja e subjekteve raportuese per</p>	<p>EITI Shqiptar / MSG</p> <p>Banka Boterore</p> <p>EITI Shqiptar</p>	<p>Mars 2021</p> <p>Prill 2021</p>	160000\$	Banka Botërore/ Donatorë të tjerë		<p>Nuk ka filluar</p> <p>Nuk ka Filluar</p>

EITI Shqiptar Plani i Punes 2021- 2022 (ver. 1.1)

		<p>Pavarur</p> <p><i>raportet EITI</i></p> <p><i>Publikimi i shprehjes se Interesit per Administratorin e Pavarur</i></p> <p><i>Zhvillimi i procesit te tenderimit dhe perzgjedhja</i></p> <p><i>Nenshkrimi i kontrates me Administratorin e Pavarur</i></p> <p>Kërkesë e Standartit EITI: Zbatimi i rekomandimeve te Raporteve të mëparshme EITI</p> <p><i>Shërbime Konsulence për të ndihmuar agjencitë qeveritare me zbatimin e rekomandimeve nga raportet e EITI (kërkesë e Standartit EITI)</i></p> <p>Publikimi i raporteve EITI</p> <p><i>Njohja e publikut te gjere me rezultatet e raporteve EITI</i></p> <p>Suport i vazhdueshem ne Proceset EITI</p> <p><i>Konsulencë për Institucionet qeveritare dhe kompanite që operojnë në industrinë nxjerrëse</i></p>	<p><i>raportet EITI</i></p> <p><i>Publikimi i shprehjes se Interesit per Administratorin e Pavarur</i></p> <p><i>Zhvillimi i procesit te tenderimit dhe perzgjedhja</i></p> <p><i>Nenshkrimi i kontrates me Administratorin e Pavarur</i></p> <p><i>Shërbime Konsulence për të ndihmuar agjencitë qeveritare me zbatimin e rekomandimeve nga raportet e EITI (kërkesë e Standartit EITI)</i></p> <p><i>Njohja e publikut te gjere me rezultatet e raporteve EITI</i></p> <p><i>Konsulencë për Institucionet qeveritare dhe kompanite që operojnë në industrinë nxjerrëse</i></p>	<p><i>EITI Shqiptar</i></p> <p><i>EITI Shqiptar</i></p> <p><i>EITI Shqiptar/IA</i></p> <p><i>EITI Shqiptar/IA</i></p> <p><i>EITI Shqiptar/IA</i></p> <p><i>IA/EITI Shqiptar</i></p>	<p><i>Maj 2021</i></p> <p><i>Qershor 2021</i></p> <p><i>Korrik 2021</i></p> <p><i>Dhjetor 2021</i></p> <p><i>Dhjetor 2021</i></p> <p><i>2021-2022</i></p>	<p></p> <p></p> <p></p> <p></p> <p><i>IA/EITI Shqiptar</i></p> <p><i>Namka Botërore</i></p>	<p></p> <p></p> <p></p> <p></p> <p><i>10000\$</i></p>	<p></p> <p></p> <p></p> <p></p> <p></p> <p></p>	<p></p> <p></p> <p></p> <p></p> <p></p> <p>Nuk ka filluar</p>
6	<p>Validimi EITI 2021</p>	<p>Zbatimi i Veprimeve Korrigjuese të Validimit të dytë</p> <p>Ref: Standarti EITI Pjesemarrja ne procesin e tretë të Validimit</p>	<p><i>Adresimi i Veprimeve Korrigjuese nga Raporti i Validimit dhe ndjekja e zbatimit të rekomandimeve</i></p> <p><i>Asistenca, venia ne dispozicion e materialeve sipas kerkesave ne procesin e validimit EITI 2020</i></p>	<p><i>EITI Nderkombëtar / MSG / EITI Shqiptar</i></p> <p><i>EITI Nderkombëtar/ MSG/ EITI Shqiptar</i></p>	<p><i>2021</i></p> <p><i>Tetor 2021</i></p>	<p><i>Nuk ka</i></p>	<p></p>	<p></p>	<p><i>Në proces</i></p> <p><i>Nuk ka filluar</i></p>

EITI Shqiptar Plani i Punes 2021- 2022 (ver. 1.1)

7	Zgjerimi i kapaciteteve EITI	Programe trajnimi për stafin e EITI Shqiptar dhe antarët e MSG	<p>Trajnime nga ASPA/DAP, Standartet e Komunikimit, Zhvillimi i Politikave Publike, Menaxhimi i Projekteve, Prokurime Publike, etj.</p> <p>Trajnim i anetareve të MSG, mbi rolin e MSG, qellimin, mundësinë dhe kapacitetet që ka për të vepruar dhe i grupeve të interesit mbi rritjen e rolit të tyre në Industrinë Nxjerrëse. Trajnim për Standartin e ri 2019+ Pronesia e Vertetë (BO), dhënia e informacioneve shpjeguese</p> <p>Përcaktimi i Kurseve të plota trajnuese ofruar nga agjenci me reputacion në këtë drejtim, siç janë Universitete, Agjenci kërkimore etj</p> <p>Pjesëmarrja e palëve të interesit në Forume ndërkombëtare, Workshop-e të fokusuar në Qeverisjen e Burimeve Natyrore</p> <p>Pjesëmarrja e Sekretariati dhe anëtarëve të MSG-së në eventet e organizuara nga Sekretariati Ndërkombëtar EITI dhe vënde të tjera implementuese për të ndarë përvojën shqiptare, për të krijuar lidhje me vendet e tjera zbatuese për të mundësuar ndarjen më të mirë të njohurive dhe zbatim</p>	<p>EITI Shqiptar/ASPA/DAP</p> <p>EITI Shqiptar/MSG</p> <p>EITI Shqiptar/MSG</p> <p>EITI shqiptar/MSG/Sekretariati Ndërkombëtar EITI/Vënde të tjera implementuese</p>	<p>2021-2022</p> <p>2021-2022</p> <p>2021-2022</p> <p>2021- 2022</p>	<p>ASPA/DAP</p> <p>Banka Botërore</p> <p>Banka Botërore</p>	<p>Nuk ka</p> <p>60000\$</p> <p>20000\$</p>		<p><i>Në vijim</i></p> <p><i>Nuk ka filluar</i></p> <p><i>Nuk ka filluar</i></p>

EITI Shqiptar Plani i Punes 2021- 2022 (ver. 1.1)

		<i>implementim më efektiv të EITI-t. Shqipëria më e vetëdijshme për zhvillimet e fundit në Standardin EITI.</i>	<i>më efektiv.</i>						
8	Vlerësimi i impaktit EITI për 10 vjetorin (10 Years of Transparency); EITI Transparency Week	Një seri takimesh dhe seancash informuese një javore mbi transparencën e industrive nxjerrëse dhe mireqeverisjen e Burimeve Natyrore. Një vlerësim i impaktit që implementimi i EITI-t ka pasur këto 10 vite në Shqipëri	<i>Java e Transparencës së Industrive Nxjerrëse do të shfaqë tema të ndryshme që lidhen me EITI të tilla si gjinia, transparenca e Pronareve Përfitues (Beneficial Ownership, raportimi sistematik i të dhënave dhe mireqeverisja e industrive nxjerrëse, etj. Përzgjedhja e një konsulenti i cili nëpërmjet anketimeve, google forms apo metodave të tjera do të bëjë vlerësimin e impaktit që ka pasur EITI në Shqipëri në këto 10 vite implementimi.</i>	<i>EITI Shqiptar/MSG/ Grupe Interesi/ Konsulenti</i>	<i>2021</i>	<i>Banka Botërore</i>	<i>30000\$</i>		<i>Nuk ka filluar</i>
9	Studim për rishikimin ligjor për raportimin në bazë projekti	Studim për analizimin dhe vlerësimin e bazës aktuale ligjore për raportimin në bazë projekti. ndyshimeve që duhen bërë për të mundësuar raportimin në bazë projekti të kompanive minerare	<i>Shërbime konsulence për analizimin dhe vlerësimin e bazës aktuale ligjore për raportimin në bazë projekti. Identifikimi ndyshimeve që duhen propozuar për të mundësuar raportimin në bazë projekti të kompanive minerare</i>	<i>EITI Shqiptar/MSG/ Konsulenti</i>	<i>2021</i>	<i>Banka Botërore</i>	<i>20000\$</i>		<i>Nuk ka filluar</i>
10	Vlerësim për impaktin e Ligjit për BO	Vlerësimi i impaktit të Ligjit për Pronarët Përfitues dhe dhënia e propozimve për përmirësime të mundshme	<i>Shërbime konsulence për analizimin dhe vlerësimin e impaktit të hyrjes në fuqi dhe implementimit të Ligjit për Pronarët Përfitues.</i>	<i>EITI Shqiptar/MSG/ Konsulenti</i>	<i>2022</i>	<i>Banka Botërore</i>	<i>20000 \$</i>		<i>Nuk ka filluar</i>
11	Studim për Tranzicionin e Energjiave/	Scoping Study për përfshirjen e energjiave të	<i>Shërbime konsulence për vlerësimin e prodhimit/përdorimit të energjiave të rinovueshme dhe gazit në Shqipëri dhe</i>	<i>EITI Shqiptar/MSG/Konsulenti</i>	<i>2021</i>	<i>Banka Botërore</i>	<i>35000\$</i>		<i>Nuk ka filluar</i>

EITI Shqiptar Plani i Punes 2021- 2022 (ver. 1.1)

	<i>Energy Transition në sektorin e Energjive te Rinovueshme: Gazit/Erës/Solarit;</i>	<i>rinovueshme dhe gazit në Raportin EITI</i>	<i>mundësia e përfshirjes së tyre në Raportin EITI.</i>						
12	<i>Siguria në punë në Sektorin e Industrive Nxjerrëse</i>	<i>Vlerësim i Legjislacionit aktual për sigurinë në punë të Industrive Nxjerrëse</i>	<i>Shërbime konsulence për shqyrtimin e Legjislacionit aktual për sigurinë në punë të Industrive Nxjerrëse, case study i disa prej kompanive që aktualisht punojnë në këtë sektor dhe vlerësimi sesi këto kompani e implementojnë legjislacionin në fuqi.</i>	<i>EITI Shqiptar/MSG/ Konsulenti</i>	2021	Banka Botërore	35000 \$		<i>Nuk ka filluar</i>
13	<i>Bashkëpunimi me universitetet dhe botën Akademike për përfshirjen në procesin EITI;</i>	<i>Nisja e një procesi bashkëpunimi për përfshirjen e botës akademike në procesin EITI</i>	<i>Krijimi i marrdhënieve dhe fillimi i bashkëpunimit me universitetet dhe institucione të tjera akademike nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve për përfshirjen e tyre të vazhdueshëm në procesin EITI</i>	<i>EITI Shqiptar/Universitet/ nstitucione të tjera akademike</i>	2021-2022	Banka Botërore	10000\$		<i>Nuk ka filluar</i>
14	<i>Studim Gratë dhe Industritë Nxjerrëse</i>	<i>Studim për përfshirjen e grave në industrinë nxjerrëse. Zhvillimi i strategjisë së integrimit gjinor dhe ndërtimi i kapaciteteve për industritë nxjerrëse.</i>	<i>Shërbime konsulence për analizimin dhe vlerësimin e përfshirjes së grave në industrinë nxjerrëse aktuale. Vlerësim i mundësive për një përfshirje më të madhe të tyre, zhvillimi i strategjisë dhe ndërtimi i kapacitetit të palëve të interesit për integrimin më të madh të grave në industritë nxjerrëse</i>	<i>EITI Shqiptar/MSG/ Konsulenti</i>	2021	Banka Botërore	30,000 \$		<i>Nuk ka filluar</i>
15	<i>Për zhvillimin e një standarti për Raportimin Lokal</i>	<i>Shërbime konsulence për zhvillimin e një standarti për Raportimin Lokal</i>	<i>Shërbime konsulence për vlerësimin Raportimit Lokal dhe zhvillimin e një Standardi Lokal të Raportimit në zonat e pasura me burime natyrore.</i>	<i>EITI Shqiptar/MSG/ Konsulenti</i>	2021	Banka Botërore	35.000 \$		<i>Nuk ka filluar</i>
16	<i>Mbështetje për Shoqërinë Civile</i>	<i>Nxitja e krijimit të një mjedisi të shëndetshëm që</i>	<i>Nxitja e krijimit të një mjedisi të shëndetshëm që inkurajon pavarësinë e shoqërisë civile, efikasitetin dhe</i>	<i>EITI Shqiptar/ Shoqëria Civile</i>	2021-2022	Banka Botërore	30000 \$		<i>Nuk ka filluar</i>

EITI Shqiptar Plani i Punes 2021- 2022 (ver. 1.1)

		<i>inkurajon pavarësinë e shoqërisë civile, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë në procesin shqiptar EITI.</i>	<i>qëndrueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e shoqërisë civile shqiptare në procesin shqiptar EITI, nëpërmjet mbështetjes financiare për aktivitete të organizuara nga/për shoqërinë civile në shërbim të procesit.</i>						
17	<i>Studim për analizimin e përparësive dhe pengesave për investimet e huaja në Shqipëri</i>	<i>Shërbime konsulence për analizimin e përparësive dhe pengesave për investimet e huaja në Shqipëri</i>	<i>Analizë e problematikave që hasin dhe përparësive që kanë investitorët e huaj në sektorin e industrive nxjerrëse në Shqipëri.</i>	<i>EITI Shqiptar/MSG/ Konsulenti</i>	<i>2021-2022</i>	<i>Banka Botërore</i>	<i>25000\$</i>		<i>Nuk ka filluar</i>
18	<i>Vlerësim i impaktit të industrisë naftë nxjerrëse në zonat ku ajo operon</i>	<i>Shërbime konsulence për analizimin e ndikimit të industrisë naftë nxjerrëse në zonat ku ajo operon.</i>	<i>Analizimi i ndikimit të aktiviteteve naftë nxjerrëse, të lidhura me proceset teknike, lëkundjet siesmike, ndotja e tokës, ujit dhe ndikimi që ajo ka në jetën e banorëve të zonave përkatëse.</i>	<i>EITI Shqiptar</i>	<i>2022</i>	<i>Banka Botërore</i>	<i>30000\$</i>		<i>Nuk ka Filluar</i>
<i>Totali i pritur për Aktivitetet e financuara potencialisht nga BB/ Donatorë të tjerë (pa shpenzime operative)</i>							<i>670000 \$</i>		
<i>Totali i Pritur per aktivitetet e propozuara</i>							<i>670000\$</i>		
<i>Burime financimi të paidentifikuara / potenciale</i>									